

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Balla në Konferencën e Kryetarëve: Kërkesa për komision hetimor për "KAYO" nuk plotëson kriteret kush tetuese dhe ligjore
ADRESA	https://dosja.al/politike/balla-ne-konferencen-e-kryetareve-kerkesa-per-komision-hetimor-per-kayo-i514581
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:11:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 07:56:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1b4cdac9ae907f9e554126c2417e130f6933cb0dc05950d0add9acdb203b94c2
TEKSTI	741ed5922036d326009c2fc35d338ad84a3548a2a2c4056f295899229a29f2cb
PAMJA	d65eeac491c9e171e26026a28289744de5b15daab7ef4e830c426852b33c94f4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	841b529a97cf8710ab3d5b6b2ae48b2f4b6c0e6be63c62121cce2332c38800fc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	08125200eaf71731bdbb8a1cab166a4681f18204dc61aa429d5ceda9de8c2ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/841b529a97cf8710ab3d5b6b2ae48b2f4b6c0e6be63c62121cce2332c38800fc

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

9 SEKONDA ME PARE

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, policia vendos gardh metalik në akset kryesore afër godinës

14 ORE ME PARE

Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh: Nesër protestë para Parlamentit

21 ORE ME PARE

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë

1 DITE ME PARE

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

Politike

Balla në Konferencën e Kryetarëve: Kërkesa për komision hetimor për "KAYO" nuk plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore

Ai theksoi se në kërkesë nuk janë identifikuar veprime apo mosveprime konkrete të zyrtarëve publikë, aktet apo kontratat që pretendohet se janë të paligjshme, si dhe periudha kohore ku duhet të shtrihet hetimi.



17 Shtator 2026, 09:56
Nga E.d



Taulant Balla

TIRANA- Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, gjatë mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, deklaroi se kërkesa për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar lidhur me shoqërinë "KAYO" Sh.A. nuk përmbush kriteret kushtetuese dhe ligjore të parashikuara për ngritjen e një komisioni të tillë.

Sipas Ballës, nga pikëpamja përmbajtësore, kërkesa nuk individualizon një "çështje të veçantë", siç kërkohet nga Kushtetuta, pasi objekti i hetimit është konceptuar në mënyrë tepër të gjerë dhe përfshin një sërë çështjesh të ndryshme, pa përcaktuar qartë faktet konkrete që duhet t'i nënshtrohen hetimit parlamentar.

Ai theksoi se në kërkesë nuk janë identifikuar veprime apo mosveprime konkrete të zyrtarëve publikë, aktet apo kontratat që pretendohet se janë të paligjshme, si dhe periudha kohore ku duhet të shtrihet hetimi. Sipas Ballës, objekti i propozuar synon kontrollin e përgjithshëm të veprimtarisë së shoqërisë dhe jo hetimin e një çështjeje të individualizuar me rëndësi të veçantë publike.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 17 SHTATOR 2026, 08:30

"Ju erdhi fundi"/ Sot dita e 110-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!

BOTA 17 SHTATOR 2026, 07:24

Lufta në Lindjen e Mesme/
SHBA po përballat me
mungesë municionesh prej
luftës me Iranin

Balla argumentoi gjithashtu se tete pikat e paraqitura ne objektin e hetimit kane natyre heterogjene, duke përfshirë marrëdhënie kontraktuale, veprimtari prodhuese dhe tregtare në fushën ushtarake, fonde buxhetore, dyshime për trafik armësh dhe detyrime ndaj NATO-s. Sipas tij, një shtrirje e tillë nuk lejon përcaktimin e qartë të kufijve të hetimit dhe nuk përmbush standardin kushtetues për ekzistencën e një çështjeje të veçantë.

Kreu i Grupit Parlamentar të PS-së theksoi se kërkesa nuk paraqet indicie konkrete dhe të mjaftueshme për paligjshmëri. Ai nënvizoi se vendimet e Këshillit të Ministrave, krijimi i shoqërive të përbashkëta nga "KAYO" Sh.A., raportimet mediatike apo audiopërgjimet e publikuara nuk përbëjnë në vetvete prova të mjaftueshme për të krijuar një dyshim të arsyeshëm për veprimtari të paligjshme.

Sipas Ballës, ngritja e një komisioni hetimor parlamentar nuk mund të bëhet për të mbledhur informacion me qëllim zbulimin e mundshëm të paligjshmërive, por duhet të mbështetet paraprakisht në të dhëna dhe indicie konkrete që justifikojnë kontrollin parlamentar.

Ai ngriti shqetësimin edhe për mundësinë e mbivendosjes së hetimit parlamentar me verifikimet e nisura nga Prokuroria e Posaçme lidhur me audiopërgjimet e publikuara në media. Sipas Ballës, një situatë e tillë mund të krijojë konflikt kompetencash dhe të cenojë parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve.

Në përfundim, Balla u shpreh se, megjithëse kërkesa plotëson kriterin formal të numrit të deputetëve firmëtarë, ajo nuk përmbush kriteret përmbajtësore kushtetuese dhe ligjore për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar. Sipas tij, mungesa e individualizimit të një çështjeje të veçantë, objekti i gjerë dhe i paqartë, mungesa e indicieve konkrete për paligjshmëri dhe rreziku i ndërhyrjes në kompetencat e organeve të drejtësisë nuk krijojnë bazën e nevojshme për ushtrimin e kontrollit hetimor parlamentar në formën e kërkuar./Dosja.al

taulant balla

Sondazh

Poll

Politike

17 Shtator 2025, 09:40

PD kërkon ngritjen e Komisionit Hetimor për KAYO-n/Bardhi: Ka shpenzuar 34 milionë euro nga buxheti i shtetit pa prodhuar asgjë

Gazment Bardhi TIRANA- Opozita i kërkuar maxhorancës ngritjen e komisionit hetimor për veprimtarinë e KAYO-s. Në konfer...

Sot kalon për votim drafti i PS për pagat e magistratëve/ PD kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës: Të hiqet ligji për statusin e magistratëve

Politike

17 Shtator 2025, 09:19

AKTUALITET 17 SHTATOR 2025, 07:16

Të rinjtë u lënë vendin të moshuarve/ Punësimi i pensionistëve dyfishohet në tre vjet

më të klikuarat

Përgjimet dhe akuzat për tregti armësh, reagon kompania ku u përgjuan: Ron Yeffet nuk na përfaqëson, përgjimi ishte i paautorizuar

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro



Të shtënat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit (EMRAT+PAMJET)

Qytetarët i 'zënë pritë' në rrugë Olta Xhaçkës: O Olta o hajdute, ju erdhi fundi (VIDEO)

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow

Sot seancë plenare në Kuvend/ Në fokus
pesë interpelanca dhe pagat e gjyqtarëve
e prokurorëve

Politike

17 Shtator 2026, 08:34

Vendimi ndaj katër ish-krerëve të UÇK-
së/ Ellis: Aktgjykimi mund të sfidohet si
në fakte, ashtu edhe në ligj

Politike

17 Shtator 2026, 07:59

"Kjo betejë nuk ka mbaruar"/ I ati u
dënua me 25 vite burg, reagon djali i
Hashim Thaçit: Historinë tonë nuk mund
ta ndryshojë asnjë vendim

Politike

16 Shtator 2026, 22:09

Politike

16 Shtator 2026, 21:52

Vuçiç i pakënaqur me vendimin e Hagës/ Kritikon reagimet e Ramës dhe Kurtit: Imagjinoni sikur një zyrtar i yni të thoshte ‘Liria ka emër’

Aleksandar Vuçiç SERBI- Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka
reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializu...

Mario Keputa emërohet zv.ministër i
Ekonomisë dhe Inovacionit

Politike

16 Shtator 2026, 21:36

Gjenerali i NATO-s: Jam i shokuar me

vendimin e riages, i naçi nuk eshte kriminel

Politike

16 Shtator 2026, 21:22

"Në ç'emër flet kjo gjykatë"/ Dënimi i ish-liderëve të UÇK, reagon Rexhep Meidani: Konteksti historik s'diskutohet, populli viktimë e dhunës serbe

Politike


16 Shtator 2026, 19:59

Deputetja e PDK: Të nisin procedurat për zhbërjen e Gjykatës Speciale

Politike

16 Shtator 2026, 19:44

MË SHUMË



Protesta para Kuvendit, polica bllokoi me gardh metalik zonën

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEMBERSHIP: NGA Mediasdesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.